



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 29.03.2024

Prot.18 (tetëmbëdhjetë)

Protokoll nr. 18

I mbajtur sot më datë 29.03.2024, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

- 1.Hapja e mbledhjes (korumi,miratimi i rendit të ditës,vendimet e mbledhjes së kaluar);
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 01.03.2024.
- 3.P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shkurt 2024”;
- 4.P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;
- 5.P-V “Për miratimin e merrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët, të bashkisë Maliq, Dorcas Albania, Misionin Emanuel dhe Këshillin e Qarkut Korçë, me qëllim hapjen e Qendrës ditore për fëmijë ”;
- 6.P-V “Për bashkëfinancim projekti Ndërtim Palestra e Shkollës së Mesme *Tafil Rexhepi Pirq*”;
- 7.P-V “Për miratimin e Planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollar 2024-2026 për Bashkinë Maliq”;
- 8.P-V “Për ndarjen e planit të bursave për arsimin profesional viti shkollar 2023-2024”;
9. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi;Pranvera Begolli; Aramando Dautllari; Klea Baçi; Fevri Sherifi;Enida Avdolli; Xhuana Hoxhallari; Eriseld Jonusllari; Plator Collaku; Yllson Ibrahimlli; Server Xhuti ; Faslli Zholi; Neresida Shindo; 17 (shtatëmbëdhjetë) këshilltarë.

Mungesa: Ilia Xhuti; Rovena Terolli; Marainathi Avrami; Eglantina Balli; Albina Xhejo; Dalina Krekas; Idlir Limllari; Dritan Çami; Andonaq Risto; Almir Elezi; Gentiana Drabo; Danjela Ibrahim;

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu;Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përfaqëseuese të Arsimit Parashkollar në Bashki; Koordinatore BtF; znj.Vilma Petro.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të bashkisë Maliq, me rend dite prej 8 pikash, shkojnë 9 nëse marrim dhe pikën diskutime të tjera, me tëcilin ju jeni njohur dhe materialet. Fillimish verifikojmë korumin, korumi realizohet, në sallë janë 17 Këshillatarë, kështu që mund të procedojmë me mbledhjen. Miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet rend i ditës me 17 vota pro, Faleminderit! Ju lutem të miratojmë proceverablin e mbledhjes së dates 01.03.2024. E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet proceverabli i mbledhjes së kaluar me 17 vota pro, Faleminderit!

Ornildi Demollari: Më lejoni tju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, kemi marrë gjithësej 13 vendime, nga të cilët 3 me karakter noramtiv dhe 10 me karakter kolektiv, vendimet me karakter normativ kanë marrë dakortësinë ligjore nga ana e Prefektit të Qarkut. Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shkurt 2024"; Do i lutesha në fillim përfaqësuesve të Komisioneve nëse kanë diçka? Më vonë kalojmë në diskutime.

Petrin Kupe: Në emër të Komisionit të Financës, ne paraprakisht shqyrtuan P-V që kanë karakter finanziar, ndihmën ekonomike, ndihmë financiare si dhe projketin për bashkëfinancim, meqëns e morra fjalën do flas për të tre P-V. Të gjitha P-V janë konform ligjit si dhe projekti tjetër ai i bashkëfinacimit është i bazuar në ligj, për ne është një kontribut i rëndësishëm edhe pse 20%, pjesa tjetër mbulohet nga Ministria e Arsimit, për filluar proceduarta përfundim e ndërtimit e atij objekti në shkollën e Pirgut, jemi dakord ti miratojmë edhe pse Komisioni nuk ishte i plotë, por shumica ishte prezent, nëse dikush ka edhe diçka tjetër, përvëç shpjegimit që do bëjë Kryetari.

Ornildi Demollari: Ka diçka tjetër? Kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ti kalojmë në votim secilin P-V më vete.

Ornildi Demollari: Kalojmë në votim pikën 3?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet pika 3 me 17 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"; Komisioni i Financës.

Petrin Kupe: Në emër të Komisionit të Financës, u shpreha dhe për këtë P-V.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Qyetarja F.Xhengo:Kërkoj një ndihmë financiare, kam bërë dhe një kërkesë, para pak kohësh, vajza ime pati një incident, një rrënie zjarri në dhomën ku jeton dhe studion në Tiranë, për fat të mirë, pati vetëm dëme materiale, para pak kohësh më ka ndruar jetë dhe bashkëshorti dhe jam në kushte të vështira ekonomike.Faleminderit!

Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:Ermando Petriti:Si rast është parqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social, e kemi diskutar dhe me zonjën si do procedojmë, ne kemi patur raste të tjera më emergjente për të trajtuar dhe buxheti është pak i kufizuar, kemi vendosur ta trajtojmë në muajin e ardhshëm.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për rastin në fjalë nuk jam në djeni e vëtmja arsyё është që zjarri ka rënë në territor që nuk i përket bashkisë Maliq, Këshilli ta shoh si rast si familje me probleme.Do i propozoj Këshillit ti akordohet një shumë prej 50.000 lekë, të përfishet te P-V i sotëm.Faleminderit!

Faslli Zholi:Jam dakord me ato që thotë zonja, por të kemi më shumë informacion për familjen dhe kushtet ekonomike në të cila ndodhet.

Pranvera Begolli:F.Xhengo, jeton në bllokun nr.3 Maliq është një familje që ka qenë gjithmonë në nevojë për shkak të kushteve shëndetësore dhe ekonomike. Nuk ka të ardhura të tjera në familje.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të plotësojë dokumenta të jenë pjesë e një dosje si familjet e tjera.

Ornildi Demollari:Kalojmë në votim pikën 4? Me shtesën prej 50.000 lekë për familjen?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet pika 3 me 17 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës, "Për miratimin e merrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët, të bashkisë Maliq, Dorcas Albania, Misionin Emanuel dhe Këshillin e Qarkut Korçë, me qëllim hapjen e Qendrës ditore për fëmijë";

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ky është një projekt që ne e zbatojmë për herë të parë, si eksperiencë ne e kemi marrë nga bashkia Korçë.Bëhet fjalë për ngritjen e një Qendre ditore për fëmijë, ku ata do të bëjnë kurse do marrin mësimet të ndryshme do marrin ushqim, mendoj se do jemi një support i rëndësishëm për fëmijë dhe veçanërisht për ata në nevojë.Do e hapim si fillim me 20-25 fëmijë, më vonë duke parë situatën do shohim si do veprojmë dhe duke pare financat që do kemi.Ky është një bashëprunim midis disa aktorve si Dorcas Albania, Misioni Emanuel dhe Këshilli i Qarkut Korçë, ne si bashki do mbulojmë vetëm qiranë e ambjenteve, pjesën tjetër do e mbulojnë dy donator të tjera, fondi është parshikuar në buxhet dhe është miratuar nga ana juaj, duhet një vendim për bashkëpunimin tre palësh i cili do jetë shumë rezultativ.Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet pika 3 me 17 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V “Për bashkëfinancim projektit Ndërtim Palestra e Shkollës së Mesme *Tafil Rexhepi Pirg*”;

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ky projekt tashmë është fituar nga bashkia jonë, jemi shpallur fitues për ndërtimin e Palestrës të shkollës të mesme të fshatit Pirg, vetë udhëzimi e ka patur si kusht kur aplikon, kjo dhe në bazë të fuqisë të bashkisë dhe të popullsisë, ka një raport bashkëfinancimi me vlerë 20%, ne e kemi parshikuar në buxhet për vitin 2024 dhe 2025, të cilën ja u kemi shpjeguar dhe në P-V dhe Relacion. Shkolla e Mesme Tafil Rexhepi Pirg, është një nga shkollat më të mëdha që ka bashkia me rreth 500 nxënës, e ka shumë të domozdoshme ndërtimin e një palestre, sidomos gjatë periudhës të dimirit, palestra do jetë me ngroje, kjo ngrohje do mbulojë dhe gjysmën e shkollës që ngrohet me dru zjarri për momentin, spese gjysma tjetër ngrohet me Kaldajë. Shumë faleminderit!

Faslli Zholi:Shkolla nuk ka palestër fare?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Jo nuk ka.

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet pika 3 me 17 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollar 2024-2026 për Bashkinë Maliq”;

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollar 2024-2026 për Bashkinë Maliq është një zhvillim i ri për bashkinë tonë, që do na vijë në ndihmë për disa aspekte që ne i kemi shumë të domozdoshme, është bërë një dëgjesë publike për këtë dhe ka patur shumë aktorë, ndër ta dhe Këshilltarë dhe ishte shumë pozitive që kishte nga të dyja krahët e Këshillit, atje pati shkëmbim idesh se si do përmirësohet arsimi parashkollar, që një fare mënyre varet nga bashkia, ku ne bëjmë emërime sipas portalit, mirëmbajmë godinat, ende nuk kemi specialisitet e duhur për kurikulat etj, u dikustuan shumë elementë që zyra arsimore do e verë zbatim dhe këtu ne do i pjesë të buxheteve tona në vazhdim.Dua të falendetoj dhe projketin Bashki të Forta për mbështeten.

Faslli Zholi:Dua si fillim ti bëj një vërrëjtje dhe vetes dhe Kryesisë, kjo për shkak të funksionimit më mirë Komisioneve të Këshillit.Unë isha pjesë e diskutimeve si anëtar i Komisionit të Arsimit për këtë çështje që po diskutojmë.Dua të shtoj dhe këtu diçka dhe ne jmei



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

në një zë për sa i përket arsimit parshkollar, që duhet të kemi kushte më të mira. Informacioni duhet të jetë më i detajuar, se cfarë problemi ka çdo kopsht më vete, për sa i përket materialve didaktike në material sqarohej shumë mirë dhe mendimi im është që ka vend për përmirësimë, për këtë ne ne si Këshilli nuk duhet të kursehem që këto struktura të funksionojnë sa më mirë. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet pika 3 me 17 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, P-V “Për ndarjen e planit të bursave për arsimin profesional viti shkollor 2023-2024”; Janë dy nxënës që I kanë sjellë dokumenat me vonesë.

Ornildi Demollari: Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet pika 3 me 17 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës, Diskutime të tjera.

Ornildi Demollari: Ju kujtoj se në datë 31.03.2024, zhvillohen zgjedhjet për Kujdestar fshati në Drithas Poshtë, pas mbledhjes Komisioni i Mandateve, Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Strukturave Komunitare të mblidhet për të diskutar lidhur me cerftifikimin e kandidaturave për Kujdestar fshati. Kemi diçka tjetër?

Nersida Shindo: Mbledhjen e parë kam ngritur shqetësimin e pengesave të makinave në fshatin Rrëmbec.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shqetësimi është me vend, patjetër që do e shoh pas mbeledhjes. Faleminderit!

Faslli Zholi: Dua të ngre shqetësimin e punishtes në fshatin Libonik, është në punë akoma? Dhe kërkojmë një ambjent për subjketin tonë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Punishtja nuk është më në punë, do e shohim dhe problemin e ambjentit.

Yllson Ibrahimllari: Në faqen e Bashkisë, nuk ka të publikuar asnje rregullore të miratuar nga Këshilli i bashkisë. Kemi dhe një Kod Sjellje të Këshillit, që në mbledhjen e parë u shkel. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Me sa kam informacion ka një problem me faqen që do rregullohet shumë shpjet.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Yllson Ibrahimillari: Është e mira ti zbatojmë këto rregullore.

Qytetari F.Ibrahimillari: Ngre sheqtësimin e Komisionimi të PAK në Qendërën Shëndtësore Maliq.

Yllson Ibrahimillari: Kemi nisur diçka, le ta përfundojmë, unë do punoj njëloj dhe si anëtar i thjeshtë i Komisionit të Shëndtësisë. Të nisim një projeket standart, ka një projeket pilot të Ministisë për PAK, që njerzit mos sorllaten kot në vende të tjera për të gjetur doktorin e rradhës, sepse dhe specialistët e fushës janë rralluar shumë nga këto anë. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Komisioni i Shëndtësisë të zhvillojë një takim dhe të na sjellë një sygjerim në lidhje me këto shqetësimë që ngritët ju, por dhe ata që qytetari ngriti pak më parë. Ne si Kryesi por dhe mazhoranca, besoj se nuk ka diçka kundra për të ngritur këto probleme, ndoshta dhe duke ju drejtuar Minsitrisë së Shëndetësisë, kaq kisha për këtë pikë, do i lutesha kolegve që takimet me Komisionet përkatse ku bëjnë pjesë duhet të zhvillohen, e kemi detyrim para qytarëve. Faleminderit!

Yllson Ibrahimillari: I jam drejtuar Komisionit të vlersimit të figurave, me një listë prej tetë persona që kanë lidhje me zonën, për ti dhënë Titjujt e mundëshëm që ata vlersojnë, gjithë materiali do i kalojë znj. Floreta Zaçe, me gjithë se ne jemi dakortësuar me znj. Rudina që ky Komision do kalonte opozitës dhe drejtimin do e merrte z. Server Xhuti, e pashë të shpallur që është zni. Floreta, nuk ka asnjë problem dokumentacionin po ja dorzoj. Nëse doni po ju lexoj listën?

Petrit Kupe: Po patjetër lexoje.

Yllson Ibrahimillari: Profesori i nderuar që e keni pasur dhe ju, Gjergji Merlika, z. Merilka ka qenë profesor i shumë plejadave. Z. Sami Repishti personalitet i këshillit Shqipëtaro-Amerikan, ka qenë pjesë e kampit të Vloçishtit, Pro.Dr. Ali Refatllari, Kardio-Kirug, ka impakt të madh në zonë, personalitet në fushën e mjeksissë, Arshi Pipa, pas vdekjes, ka qenë pjesë e kampit të Vloçishtit, Mitrush Kuteli, Pasho Kolaneci, pas vdekjes, Baba Hjadar Qose, Babi i Teqes të Turanit dhe Mustafa Linçanj (Baba Kalanderi) pas vdekjes. Komisionit ti takon të shqyrtojë dokumentacionin.

Ornildi Demollari: Dorzoja komisionit. Faleminderit!

Faslli Zholi: Dua të ngrë një shqetësim për një familje nga Sheqerasi, ka djalin Tetreaplegjik dhe ja kishin hequr pagesën, prandaj duhet parë me përparsi shqetësimi që ngriti doktori, kemi dhe një rast tjetër nga lagjia Qesartë Maliq.

Ornildi Demollari: Në vijm të kësaj është shumë i nevojshëm një raport nga Komisioni i Shëndetësisë dhe në një mbledhje të rradhës ta sjellë reportin bashkë me sygjerimit se si duhet të veprojë këshilli për këtë shqetësim, është një shqetësim që dhe unë si qytetar e kam hasur.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Endia Avdolli:Duhet të mblidhem si fillim për të parë se cilat janë problematikat dhe pastaj të shohim se çfarë hapësira ligjore kemi ne për të ndërhyrë.Sygjerim ishte shumë me vend, do e kemi patjetër prioritet.Faleminderit!

Ornildi Demollari:Faleminderit! Kemi diçka tjetër?

Petrit Kupe:Kam dhe unë diçka lidhur me propozimet që bëri doktori, vërtet materialet duhet ti marri Komisioni i Tutujve të Nderit, por unë mendoj që materialet ti kalojnë Komisionit që është ngritur me VKB dhe ka figuara nga të gjitha fushat, unë e përkrah si nismë, që duhet të vlersohen figurat, por jam për ata që janë në territorin e bashkisë, duhet të shohim figura jo vetëm në aspektin atdhetar dhe fetar po duhet të shohim figura që kur është krijuar pushteti lokal, në vitin 1992 dhe mund të ketë figura që janë vlersuar më parë dhe mos kemi përplasje dhe jam i mendimit që disa prej tyre që unë i njoh, të kalohet me procedurat dhe të miratohen.E pëershndes nismën e doktorit si Gorar që jeton në Tiranë. Faleminderit!

Yllson Ibrahimlli:Pashaportzimin e kam në Gorë, kam shtëpi dhe biznes të mbetur. Faleminderit!

Pranvera Begolli:Kryetar dhe unë jam dakord me propozimet e z.Yllson, dua të mëshoj te z.Gjegji Merlika që ka qenë profesor dhe ka jetuar në Maliq dhe më vonë në Senisht, ku e dënuan dhe ka ndihmuar në elektrifikimin e fshatit.Komisioni i madh në bashki ti shohë propozimet e bëra.

Ornildi Demollari:Faleminderit! Nëse nuk kemi diçka tjetër? Këtu mbylljet mbledhja e Këshillit bashkiak.

Ornildi Demollari: Kjo ishte mbeldhja për sot.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

